

VENDIM

Nr.657, datë 04.08.2010

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR.405, DATË 8.1.1996 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR ADMINISTRIMIN E RRJETIT RRUGOR KOMBËTAR DHE RRJETIT RURAL TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "c" të nenit 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.405, datë 8.1.1996 të Këshillit të Ministrave, të bëhet ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në pikën 1, rrjetit rrugor kombëtar i hiqen akset rrugore, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Në tabelën "Inventari i rrugëve rurale, rajonale e komunale", të përmendur në pikën 4/1, të shtohen segmentet rrugore, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Brendshme, Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Lidhja nr.1

SEGMENTET RRUGORE QË DO TË KALOJNË NGA INVENTARI I RRUGËVE
NACIONALE NË INVENTARIN E RRUGËVE RAJONALE RURALE

- 1 Aksi rrugor Burrel- Komsî 7 km Rruga nr.37
- 2 Aksi rrugor Këlcyrë - Ballaban - Kufi Berat 35 km pjesë nga rruga nr.74
- 3 Aksi Leskovik - Sarandopor 11 km Rruga nr.65
- 4 Aksi rrugor Rrëshen - Prosek - Kurbnesh - Lurë 56 km Rruga nr.34
- 5 Aksi rrugor Kuç - Borsh (pjesë e Kote - Kuç - Borsh) 22 km
- 6 Aksi rrugor Fushë Arrëz - Iballë 60 km
- 7 Krujë - Qafshamë 26 km pjesë nga rruga nr.38
- 8 Gramsh - Grabovë - Maliq (vetëm për një lot 38.8 km) 38.8 km pjesë nga rruga nr.71
- 9 Fier - Kraps - Lalar 10 km
- 10 Libonik - Rrëmbec - Plase 13 km Rruga nr.101
- 11 Kukës - Shishtavec 31 km Rruga nr.26
- 12 Hani i Hotit - Tamarë 31 km Rruga nr.20
- 13 Aeroport - Kolesian - Domaj 12 km pjesë nga rruga nr.31
- 14 Boge - Theth 27 km pjesë nga rruga nr.21